



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

Nr. 2837 Prot

Kukës, 07.06.2024

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Tema e konsultimit:

Projektvendim

“Për miratimin me shkrim për vijimin e procedurave për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të fondit pyjorpublik të sipërfaqes 0,677 HA, shfrytëzim mineral kromi me karrierënë funksion të aktivitetit të shoqërisë “PEPA GROUP”, Sh.P.K, leje minerare Nr.1886/1

Propozuesi i konsultimit:

Këshilli Bashkiak

Informacion për konsultimin:

Ministria e Mjedisit e Turizmit për Subjektin ekonomik “Pepa Group”, sh.p.k i cili ushtron aktivitetin në fushën e shfrytëzimit mineral, ka kërkuar nga Bashkia Kukës dhënien e dakordësisë për heqje nga fondi pyjor të sipërfaqes 0,677 HA që ndodhet në nënngastën 92/b, të ekonomisë pyjore Mamëz-Kalimash. Përpara shqyrtimit të këtij projektvendimi, Këshilli Bashkiak organizon takimin me banorët e Njesisë Administrative Surroj (fshatrat e kësaj njësie), të bëhen pjesë e vendimmarrjes duke dhënë mendimet, rekomandimet e sugjerimet e tyre.

Vendi, koha e konsultimit:

Konsultimi do të organizohet ditën e enjte, me datë 27.06.2024 ora 12⁰⁰ në fshatin Fushar.

Aktorët pjesëmarrës në konsultim:

Nga organizatorët:

Kryetari/Anëtarëte Këshillit Bashkiak/Sekretari i Këshillit Bashkiak, Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve dhe Mjedisit, Përfaqësues nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.

Nga të ftuarit:

Banorë të Njesisë Administrative Surroj, Kryetarë e Anëtarë të Kryesive të fshatrave, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.

Forma e konsultimit:

Marrja e opinioneve dhe mendimeve nga të pranishmit në konsultimin publik, nëpërmjet diskutimeve, pyetjeve, propozimeve dhe rekomandimeve, paraqitja e konkluzioneve në mbledhjet e komisionit përkatës dhe mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Me respekt,

Kryetari i Këshillit
Albert MUJA

